



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Statistical Agency of Kosovo



Shpalljen e Konkursit Publik për Regjistruues dhe Mbikëqyrës në Regjistrimin e Popullsisë

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës Regjistrimi i Popullsisë 2023
Titulli i pozitës(ave):	Mbikëqyrës dhe Regjistruues për Regjistrimin e Popullsisë 2023
Numri i referencës	ASK- ZRA
Lloji i kontratës:	Kontratë publike
Kohëzgjatja e kontratës:	2 muaj - (Për regjistruues) 2 muaj – (Për mbikëqyrësit)
Orari i punës:	Fleksibil
Numri i stafit të kërkuar:	891 Mbikëqyrës (aktiv dhe rezerva) dhe 3 503 (aktiv dhe rezerva) Regjistruues

Detyrat dhe përgjegjësitë e Mbikëqyrësve (891)

- Marrin pjesë në trajnime për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave;
- Marrin pjesë në punën praktike në terren;
- Bëjnë shpërndarjen e materialeve të nevojshme tek regjistruuesit;
- Mbajnë kontakte ditore me regjistruuesit për të cilët mbikëqyrë punën;
- Monitoron punën në teren lidhur me Regjistrimin sipas udhëzimeve;
- Ndihmojnë në rastet të veçanta regjistruuesit në identifikimin e Qarkut Regjistruues;
- Kontrollon materialin në aspektin e cilësisë dhe gjithë përfshirjes;

- Përgatisin raporte ditore dhe javore për ASK-në;
- Verifikojnë/aprovojnë të dhënat paraprake me të dhënat e marruara nga terreni;
- Dërgojnë të dhënat e aprovuara në selinë e ASK (zyrën qendrore) përmes sistemit të miratuar.
- Në rastin e refuzimeve të ndonjë ekonomie familjare brenda një Qarku Regjistruar, mbikëqyrësi duhet të bëjë përpjekje për gjetjen e mënyrës për marrjen e informatave e në raste të veçanta informacionin e bart në KKR me qëllim zgjidhjen e rasteve.
- Në raste të veçanta për çështje teknike duhet të marrë vendime të duhura në kohë të duhur.
- Mbledhin dhe kontrollojnë pajisjet nga regjistruesi dhe të njëjtin e dorëzon në qendrën përkatëse ku janë marrë.

Përgatitja shkollore dhe përvoja:

- Të jete shtetas të Republikës së Kosovës, përparësi kanë personat e papunë në 3 muajt e fundit;
- Të kenë diplome universitare, përparësi kanë kandidatet me note mesatare me të lartë, preferohet në drejtimet shoqërore, dhe ekonomike;
- Të jete të pajisur me patente shoferi;
- Të jete nga komuna përkatëse ku do të zhvillohet aktiviteti i Regjistrimit të Popullsisë 2023.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikimi për punë ekipore;
- Të ketë aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Të ketë aftësi shumë të mira kompjuterike.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Regjistruarëve (3 503)

- Bëjnë grumbullimin e të dhënave për Regjistrimin e Popullsisë me metodologjinë CAPI;
- Bëjnë identifikimin e të gjithë ekonomive familjare duke intervistuar Kryefamiljarin/en dhe anëtarët e tjerë të ekonomisë familjare;
- Rishqyrtojnë për intervistim të anketuarit të cilët nuk mund të intervistohen gjatë vizitës së parë;
- Përdorin adresat dhe hartat e Qarkut Regjistruar dhe ekonomive familjare brenda atij Qarku Regjistruar;
- Njoftojnë mbikëqyrësin për problemet dhe pasiguritë e mundshme;
- Bëjnë raporte ditore, javore dhe mujore lidhur me intervistat e realizuara.

Të drejtë aplikimi për regjistruet kanë personat të cilët i plotësojnë kriteret si në vijim:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës, përparësi kanë personat e papune në 3 muajt e fundit;
- Të flasin gjuhën e komunitetit në Qarkun Regjistruet;
- Të kenë të përfunduar së paku shkollimin e mesëm, përparësi kanë kandidatet me nivel më të lartë të shkollimit;
- Të jenë nga komuna përkatëse ku do të zhvillohet aktiviteti i Regjistrimit të Popullsisë 2023.

Kompetenca dhe aftësitë e kërkuara të kandidatëve potenciale për regjistruet janë të përcaktuara si në vijim:

- Të ketë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe punë ekipore;
- Të ketë aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Të ketë aftësi shumë të mira kompjuterike;
- Të jenë të gatshëm të punojnë me orar fleksibil si dhe orare të zgjatur të punës;

Konkursi është i hapur nga data 26 shtator deri më date 02 tetor 2023. Publikimi do të jetë në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së, komunave dhe institucioneve tjera të Kosovës.

Paraqitja e kërkesave:

Aplikimi për konkurs është procedurë e hapur, e cila bëhet online përmes aplikacionit si dhe me paraqitjen fizike të dokumenteve në komuna ku aplikoni. Zyrtarët komunal të caktuar që merren me aplikimin e pozitave në fjalë do të ndihmojnë (asistojnë) që në bashkëpunim me aplikuesit të bëjnë futjen e të dhënave në sistem/aplikacion. Për tu siguruar që aplikimi juaj është futur në sistem ju duhet të jeni prezent gjatë futjes në sistem të të dhënave tuaja. ***Vetëm aplikimet në sistem do të merren në konsideratë.***

Aplikimet do të pranohen jo më vonë se data dhe koha e shënuar.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:

CV, kopja e letërnjoftimit, diplomat/certifikata e nivelit me të lartë të arsimit, përvoja e punës (vërtetimi apo referenca).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të kontaktohen dhe të njoftohen me kohë.

Për informata më të hollësishme, luteni kontaktoni zyrtarët komunal në komunën që keni aplikuar.

Secila komunë do të ketë zyrtarë përgjegjës për kontakte në objekte komunale, një email adresë dhe nr. telefoni.